

PAKTI TERRITORIAL I PUNËSIMIT

Komuna e Vitisë



United Nations Development Programme

Empowered lives. Resilient nations.

Viti
GRUPI LOKAL I VEPRIMIT

Komuna e Vitisë



Komuna e Vitisë dhe UNDP në emër të grupit lokal të veprimit, shpallin këtë

THIRRJE PËR APLIKIM

Komuna e Vitisë dhe UNDP, në kuadrin e zbatimit të projektit të financuar nga Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim (ADC), "Zhvillimi i Integruar Territorial 2" (InTerDev 2), kanë zhvilluar një Pakt Territorial të Punësimit (PTP), i cili synon të promovojë krijimin dhe formalizimin e punësimit për individë të cenusshëm në komunën e Vitisë si mjet për të promovuar rritjen dhe valorizimin e territorit. Përmes kësaj iniciative projekti synon të promovojë rritjen inkluzive dhe të vlerësojë territorin. PTP i Komunës së Vitisë promovon 5 veprime të parashikuara për të siguruar mbështetje për qytetarët e komunës së Vitisë.

Ky intervenim i PTP-së është projektuar për të mbështetur familjet bujqësore në komunën e Vitisë aktualisht të angazhuar në mbarështimin e lopëve qumështore (Grupi B). Fokusi është rritja e produktivitetit dhe forcimi i lidhjeve me tregun duke shikuar kryesisht në tregun lokal (p.sh. qumështin) por edhe në tregun ndërkombëtar. Mbi 82 familje do të përfitojnë nga qasja në shërbimet këshillimore të biznesit, trajnimit, mundësitë e kreditimit (në formë të një granti të vogël), dhe ndërtimit të shoqatave.

Komuna e Vitisë dhe UNDP i ftojnë të aplikojnë të gjithë personat e interesuar që plotësojnë këto kritere.

Kriteret e përshtatshmërisë

Grupi B

- Të jenë banorë i territorit administrativ të Komunës së Vitisë (**të verifikueshme me çertifikatë familjare**);
- Të jenë familje me së paku 2 anëtarë të moshës së punës (+ 16 vjeç) – një nga ta femra (**të verifikueshme me çertifikatë familjare**);
- Në pronësi të së paku 0.5 ha tokë të punueshme (**të verifikueshme me dokument të pronës**) (prona mund të jetë në emër të aplikuesit ose një të afërmi të ngushtë: prindërit ose gjyshërit), Vërtetimi nga pronari që vërteton se ka dhënë me qira tokën e punueshme për një minimum të periudhës prej 3 vjetësh për aplikantin;
- Aktualisht mbarështon 3 lopë qumështore gjer në maksimum 7 lopë qumështore (**të verifikueshme me NiF**)

Ju njoftojmë se këto janë kritere kualifikuese. Kjo do të thotë që nëse nuk përputhesh me njërin prej këtyre, do të diskualifikohesh gjatë kontrollit të kualifikimit dhe nuk shqyrtohet më tutje për vlerësim. Nëse keni dyshime për një ose më shumë kritere kualifikuese, ju lutemi konsultoni informacionin e dhënë në dosjen e aplikacionit.

Prioriteti për këtë Thirrje për Aplikim i jepet:

- aplikanteve femra (2 pikë shtesë mbi rezultatin e marrë nga propozimi teknik dhe profilizimi i cenusshmërisë);
- aplikantët nën 35 vjeç (2 pikë shtesë)

Nëse do të përzgjidheni, do të përfitoni sa më poshtë:

- Shërbimet e këshillimit dhe zhvillimit të biznesit (BADS)
- Qasja në mundësitë e trajnimit (A2TO);
- Ndërtimin e shoqatës (AB)
- Qasja në mundësitë e trajnimit (A2TO);

Grupi B

- Depozit për ftohje të qumështit (kap. 100 litra)

Shënim: Familjet bujqësore që përfitojnë nga intervenimi regjistrohen si të vetëpunësuar në bujqësi (biznes individual). Çdo familje bujqësore do të ketë dy anëtarë të familjes të regjistruar si të punësuar.

Si të merrni Formularin e Aplikimit:

- Formularët për shprehje të interesit mund të shkarkohen nga web saitet tona <https://kk.rks-gov.net/Viti/> ose të merren formular të shtypur në zyrëne Zyrtarit të UNDP-se në Komunën e Vitisë.

Nëse ju duhen informata shtesë ose ndihmë për ta plotësuar formularët për të shprehur interesin ju ftojmë të merrni pjesë në mbledhjet informuese që organizohen nga komuna e Vitisë dhe UNDP me: **27 Mars 2019, ora: 11:00 ne Sallen e Kuvendit Komunal – Ndertesa e Shtepise se Kultures.**

Formularët origjinal duhet të dorëzohen në kopje fizike tek Zyrtari Mbështetës për Projektin e Komunës të UNDP para **dates 05 Prill 2019 ora 16:00.**

KUJDES: Ju lutemi mos harroni të merrni dokumentin që vërteton se e keni dorëzuar Formularin e Aplikimit dhe dokumentet shoqëruese në kohën e duhur.

JU LUTEMI NA NDIHMONI të promovojmë këtë Thirrje për Aplikime duke informuar njerëz të tjerë që mendoni se mund të kenë interes të aplikojnë për këtë mundësi